



# **ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTI-KORRUPSION DHE DINJITET – ÇOHU!**

**ZYRA E QEVERISJËS SË MIRË DHE SUNDIMIT TË LIGJIT**

## **RAPORT MONITORUES**

**Parashkrimi i Ndjekjeve Penale  
dhe Ekzekutimeve Penale**

**SERIA E RAPORTIT # 2**

**SHKURT 2013**

Rruja “2 Korriku” 4/4, Prishtinë, 10000  
[organizatacohу@yahoo.com](mailto:organizatacohу@yahoo.com)  
[www.cohu.org](http://www.cohu.org)

**Raport  
Monitorues** Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i  
Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të  
Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

Ky botim është realizuar me përkrahjen e **Civil Rights Defenders**- (CRD)  
Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e **Organizatës ÇOHU!**.

Përgatitur nga: Arton Demhasaj

Copyright © 2013 ÇOHU!. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistrues, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Luteni të kontaktoni: [organizatacohu@yahoo.com](mailto:organizatacohu@yahoo.com), [arton.demhasaj@cohu.org](mailto:arton.demhasaj@cohu.org), [artondemhasaj@gmail.com](mailto:artondemhasaj@gmail.com); apo +381 38 248 506.

Botuar nga:

Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, ÇOHU!  
Rruga: 2 Korriku; Nr.4; Hy.4  
Prishtinë, Kosovë  
Tel / +381 (0)38 248 506  
[www.cohu.org](http://www.cohu.org)  
[organizatacohu@yahoo.com](mailto:organizatacohu@yahoo.com)  
[office@cohu.org](mailto:office@cohu.org)

## **METODOLOGJIA:**

Ky Raport Monitorues, është rezultat i hulumtimit kualitativ dhe kuantitativ i cili përbazë ka burime primare dhe sekondare. Sa i përket burimeve primare, janë përdorur metodat e intervistimit direkt të akterëve relevant të fushës së gjyqësorit (gjykatat komunale, Koordinatori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor, Kryetari i Gjykatës Supreme, Policia e Kosovës), si dhe analizimi i të dhënave nga Gjykatat komunale të Kosovës.

Po ashtu, për nevoja të këtij raporti, janë konsultuar edhe Ligjet penale (Kodi Penal i Kosovë, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës), si dhe aktet tjera juridike.

Për burimet sekondare, janë marrë përbazë edhe analiza tjera politikash, hulumtime të opinionit si dhe reagime që fokusohen në fushën e gjyqësorit, me theks të veçantë të fushës penale (parashkrimin e lëndëve penale). Për më shumë, janë konsultuar edhe burime të tjera të informacionit si mediet elektronike dhe të shkruara.

Në këtë raport monitorues, janë marrë përbazë 17 gjykata komunale. 5 gjykata komunale janë marrë që kanë numër të madh të banorëve (Gjykata Komunale e Prishtinës, e Prizrenit, Pejës, Gjakovës dhe Ferizajt), 5 gjykata të vogla me numër të ulët të lëndëve të parashkruara (Gjykata Komunale e Gllogocit, e Lipjanit, Skenderajt, Vushtrrisë dhe Suharekës), dhe 7 gjykata të vogla me numër të madh të lëndëve të parashkruara (Gjykata Komunale e Rahovecit, Kaçanikut, e Suharekës, e Deçanit, e Klinës, Malishevës dhe ajo e Istogut).

Raporti me të dhënat e mbledhura, klasifikohet në bazë të komunave me qëllim të pasqyrimit të gjykatave komunale me më së shumti lëndë të parashkruara. Pastaj, në raport klasifikohen lëndët e parashkruara në vite, në mënyrë që të ofrohet një pasqyrë më e qartë se në cilat vite ka më së shumti lëndë të parashkruara. Dhe në fund, të lëndët e parashkruara ndahen në bazë të kapitujve të KPRK-së, dhe kështu identifikohet se cilët janë kapitujt që kanë më së shumti lëndë të parashkruara dhe cilat janë atëveprat penale që më së shumti janë parashkruara.

**SHKURTESAT:**

**CRD- Civil Rights Defenders**

**KPRK- Kodi Penal i Republikës së Kosovës**

**LPK- Ligji Penal i Kosovës**

**ZPD- Zyra e Prokurorit Disiplinor**

**KGJK- Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

**GJK- Gjykatat Komunale**

**PQP- Prokuroria e Qarkut e Prishtinës**

**PSH- Prokuroria e Shtetit**

**GJKGJ- Gjykata Komunale e Gjakovës**

**PK- Policia e Kosovës**

**GJSK- Gjykata Supreme e Kosovës**

**PTK- Posta dhe Telekomi i Kosovës**

**PËRMBAJTJA:**

1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME:.....	1
2. HYRJE:.....	3
a) Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe	
b) Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimive	
3. TË GJETURAT E PËRGJITHSHME.....	5
Trendët e Parashkrimit të lëndëve penale 2011-2012.....	9
Parashkrimi i lëndëve kundër detyrës zyrtare.....	18
4. PËRFUNDIMI.....	25

## Përbledhje e përgjithshme:

**K**osova vazhdon të ketë një rritje enorme të numrit të parashkrimit të lëndëve penale (shqyrtime të lëndëve dhe ekzekutim të dënimive) në gjykatat komunale<sup>1</sup>, edhe në vitet 2011-2012, ashtu sikurse edhe në vitet paraprake 2001-2010.

Formalisht në Kosovë që nga viti 2010 ka filluar reformimi i sistemit gjyqësor, fillimisht me nxjerrjen e ligjit mbi gjykatat, me anë të të cilit ligj, po ndryshon edhe emërtimi dhe funksionimi i tyre. Po ashtu, si pjesë e reformimit të sistemit gjyqësor është edhe nxjerra e Kodit të ri Penal të Kosovës dhe Kodit të ri të Procedurës Penale të Kosovës. Të gjitha këto dokumente, materiale dhe procedurale në lëmin penale kanë hyrë në fuqi me 1 janar 2013. Gjithashtu, si pjesë e reformës së sistemit gjyqësor, është edhe rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjykatat dhe prokuroritë e vendit. Ky aspekt mund të jap efektin më të rëndësishëm në reformimin e sistemit gjyqësor, duke qenë se krijon infrastrukturën njerëzore të domosdoshme për fillimin e ndalimit të parashkrimit/vjetërsimit të lëndëve penale.

Me gjithë ndërmarrjen e këtyre veprimeve për reformimin e sistemit gjyqësor, prapë se prapë, trendi i parashkrimit/vjetërsimit të lëndëve penale në gjykatat komunale po vazhdon. Trendi i parashkrimit të lëndëve penale në vitet e fundit është rritur, krahasuar me parashkrimin e lëndëve penale në vitet paraprake.

Aspekti i parashkrimit/vjetërsimit të lëndëve penale është mjaft shqetësues në gjykatat komunale të Kosovës. Nga viti 2001 deri me 2012, kemi një numër të madh të lëndëve penale të cilat janë vjetërsuar, dhe si pasojë e kësaj, gjykatat nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim juridik për të ndjekur penalisht të dyshuarit, ose për të arrestuar të dënuarit. Numri total i lëndëve të parashkruara/vjetësuara në 17 gjykata komunale në vitet 2001-2012, është 8237. Në gjykatat komunale vetëm brenda viteve 2011-12 janë parashkuar 1845 lëndë penale. Po ta llogarisim në përqindje, del se rrëth 22.3 % e totalit të lëndëve të parashkruara i përkasin vetëm viteve 2011/12.

Nga gjithsej 8237 lëndë penale që janë parashkuar nga 17 Gjykata Komunale që janë marrë në shqyrtim, mbi 35.3%<sup>2</sup> e tyre që janë të kategorizuara i përkasin parashkrimit relativ, ndërsa 47.5% i përkasin parashkrimit absolut ndërsa 17.1% janë të pa

<sup>1</sup> (Tani me ligjin e ri për gjykatat, gjykatat komunale emërhoen gjykata themelore). [http://gazetazyrtare.rks.gov.net/Documents/Ligi%20per%20Gjykatat%20\(shqip\).pdf](http://gazetazyrtare.rks.gov.net/Documents/Ligi%20per%20Gjykatat%20(shqip).pdf)

<sup>2</sup> Për parashkrimin relativ të lëndëve, fajtorë konsiderohet të jenë gjyqtarët që kanë lejuar parashkrimin relativ, duke mos marrë veprime juridike, me synimin që afatin e parashkrimin e këtyre lëndëve ta dërgojnë në parashkrim absolut.

**Raport  
Monitorues** Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

kategorizuara ose janë ekzekutime të dënimive. Për lëndët e parashkruara në aspektin relativ, praktikisht duhet të fajësohen gjyqtarët, të cilët duke mos ndërmarrë asnje veprim, kanë lejuar vjetërsimin e këtyre lëndëve. Gjykatësit në vend se të luftojnë veprat e ndryshme të dënuara me ligjet në fuqi, të gjykojnë dhe të dënojnë shkelësit e ligjeve në fuqi dhe të Kodit Penal të Kosovës, ata me këto veprime kanë amnistuar kryesit e veprave të ndryshme penale. Gjykatësit, duke i mbajtur lëndët e tyre nëpër sirtarë (duke mos i shqyrta), dhe njëkohësisht duke lejuar që këto lëndë të parashkruhen, kanë pamundësuar ndërmarrjen e çfarëdo veprimeve penale kundër kryesve të ndryshëm të veprave të caktuara penale. Me këtë veprim, gjykatësit kanë shkelur mbi parimin e një gjykimi të drejtë e të pa-anshëm, duke mundësuar kështu vendosjen e një precedentit të rrezikshëm.

Ky raport monitorues, tregon që në mesin e lëndëve që janë parashkruar ka edhe lëndë që i përkasin kapitullit të KPRK-së: "Vepra penale kundër detyrës zyrtare", që klasifikohen si vepra të korruptionit.

Edhe përkundër miratimit të Strategjisë Shtetërore për Zvogëlimin e Lëndëve të Grumbulluara, në tetor të vitit 2010, strategji e cila tashmë konsiderohet e zbatuar, prapë se prapë trendi i lëndëve të parashkruara ka vazhduar edhe në vitet 2011-12. Për më keq, ka tendenca të qarta që parashkrimi i lëndëve të vazhdojë edhe në të ardhmen, nëse nuk fillohet të ndërmerren masa disiplinore dhe penale për ata gjyqtarë të cilët lejojnë vjetërsimin e lëndëve, për të cilat kanë qenë të ngarkuar që t'i shqyrtojnë.

Për këtë çështje, disa herë është përmendur se janë filluar hetime për gjyqtarët që kanë lejuar vjetërsimin e lëndëve, nga ana e Zyrës së Prokurorit Disiplinor pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, "por asnje prej tyre nuk ka rezultuar me shkarkimin e tyre"<sup>3</sup>. Brenda Zyrës së Prokurorit Disiplinor, janë hetuar gjithsej 10 raste që kanë të bëjnë më parashkrimin e lëndëve penale, nga të cilat 6 lëndë janë dërguar në komisionet përkatëse disiplinore, ndërsa 4 lëndë janë hedhur poshtë<sup>4</sup>.

Disa herë është potencuar fakti se gjykatat po lejojnë më qëllim parashkrimin e lëndëve penale me një interes të caktuar, dhe se do të ndërmerren masa ndaj tyre, por në praktikë akoma nuk ka ndonjë rezultat. Deri me sot, nuk ka asnje rast që një gjyqtar është shkarkuar për shkak se ka lejuar vjetërsimin e lëndës për të cilën ka qenë i ngarkuar ta shqyrtojë.

Sipas legjislacionit penal në fuqi, përgjegjës për lëndët që janë parashkruar në aspektin relativ janë gjykatat (gjyqtarët kompetent), dhe ndaj tyre është dashur të

<sup>3</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian i vitit 2011.

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2011/package/ks\\_rapport\\_2011\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf)

<sup>4</sup> Intervistë me Zef Prendrecaj, koordinator i Zyrës së Prokurorit Disiplinor, realizuar në Dhjetor 2012.

**Raport  
Monitorues** Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

ndërmerren masa disiplinore dhe penale për shpërdorim të detyrës zyrtare, dhe lejim më qëllim të parashkrimit të mijëra lëndëve penale që kanë qenë në duart të tyre.

**Hyrje:**

**Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimive**

Parashkrimi i lëndës penale lind kur kryesi i veprës penale nuk mund të zbulohet, ose mund të ndodhë që kryesi të dihet por organet e ndjekjes penale nuk mund ta gjejnë atë. Po ashtu, mund të ndodhë që kryesi i veprës penale të dënöhët, por pas shqiptimit të dënimit paraqiten pengesa reale apo juridike të cilat e bëjnë të pamundshëm ekzekutimin e dënimit p.sh. (i dënuari sëmurët rëndë ose arratiset pas shqiptimit të dënimit).<sup>5</sup> “Parashkrimi apo vjetërsimi është institut juridik i cili shpie në shuarjen e sanksioneve penale për shkak të kalimit të kohës së caktuar me ligj. Kur paraqitet parashkrimi, shteti humb të drejtën e zbatimit të sanksioneve penale ndaj kryesit të veprës penale”<sup>6</sup>.

Në rastet kur prej kryerjes së **veprës penale/prej shqiptimit të dënimit**, deri te **ndërmarrja e ndjekjes penale/fillimi i ekzekutimit të dënimit** ka kaluar një kohë e caktuar me ligj, nuk mund të ndërmerret **ndjekja penale/nuk mund të ekzekutohet dëni i shqiptuar**.

Prej kryerjes së veprës penale deri te fillimi i ndjekjes, bëhet parashkrimi i ndjekjes penale, ndërsa prej shqiptimit të dënimit bëhet parashkrimi i ekzekutimit të dënimit. Shteti në këto raste, sipas ligjeve që i ka nxjerrë (Kodi Penal i Republikës së Kosovës), humb të drejtën e shqiptimit apo ekzekutimit të dënimit.<sup>7</sup>

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, njeh dy lloje të parashkrimit: **1. parashkrimin e ndjekjes penale dhe 2. parashkrimin e ekzekutimit të dënimit.**

Të dy llojet e parashkrimit mund të ndahen pastaj në parashkrim relativ dhe absolut. Parashkrimi relativ<sup>8</sup>, nënkuption kalimin e afatit të paraparë me ligj prej kohës së kryerjes së veprës penale deri në momentin kur nuk mund të fillohet ndjekja ose nuk mund të fillojë ekzekutimi tek parashkrimi i ekzekutimeve të dënimive. Ndërsa parashkrimi absolut<sup>9</sup>, nënkuption kalimin e dyfishit të kohës së paraparë me ligj, prej

<sup>5</sup> Salihu, Ismet; “**E Drejta Penale**”; Universiteti Fama, Prishtinë, 2008, faqe558..

<sup>6</sup> Po aty, faqe558.

<sup>7</sup> Po aty, faqe 559-560.

<sup>8</sup> Po aty, faqe 563.

<sup>9</sup> Ndalja dhe ndërprerja e përshkrimit mund të shpijnë praktikisht në një situatë që të mos shkaktohet parashkrimi.

Sidomos me ndërprerjen gjithherë mund të ndërmarrin veprime me të cilat do të bënin të pamundshme kuptimin dhe

**Raport  
Monitorues** Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

momentit të kryerjes së veprës penale deri në kohën kur nuk mund të fillohet ndjekja, ose ekzekutimi i dënit të shqiptuar tek rasti i parashkrimi të ekzekutimeve të dënimive.

Afat i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale. Nëse kemi ndërprerje të afatit të parashkrimit, atëherë ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).<sup>10</sup>

Sipas nenit 106 të KPRK-së, **ndjeka penale** nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme:

- 1) Tridhjetë** vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim të përjetshëm;
- 2) Njëzet** vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se dhjetë vjet burgim;
- 3) Dhjetë** vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë vjet burgim;
- 4) Pesë** vjet nga kryerja e veprës së dënueshme me më shumë se tre vjet burgim;
- 5) Tre** vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim dhe;
- 6) Dy** vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një vit burgim ose dënim me gjobë.

---

qëllimin e parashkrimit. Për t'iu shmangur kësaj mundësie, e drejta penale bashkëkohore parashev parashkrimin absolut. Po aty faqe 563.

<sup>10</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 107.

**Raport  
Monitorues** Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimive fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm. Nëse afati i parashkrimit të ekzekutimit të vendimeve ndërpritet me vendim ose sipas ligjit, atëherë, ekzekutimi i dënimive ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës që kërkohet nga ligji për afatin e parashkrimit (ndalimi absolut i ekzekutimit të dënimive).<sup>11</sup>

"Nuk zbatohet asnjë afat i parashkrimit mbi ekzekutimin e dënimit për gjenocid, kime

Sipas nenit 108 të KPRK-së, **dënnimi i shqiptuar** nuk mund të ekzekutohet kur të kenë kaluar:

- 1) Tridhjetë** vjet nga dënnimi me burgim të përjetshëm;
- 2) Njëzet** vjet nga dënnimi me mbi dhjetë vjet burgim;
- 3) Dhjetë** vjet nga dënnimi me mbi pesë vjet burgim;
- 4) Pesë** vjet nga dënnimi me mbi tri vjet burgim;
- 5) Tri** vjet nga dënnimi me mbi një vit burgim dhe;
- 6) Dy** vjet nga dënnimi me burgim deri në një vit apo dënnimi me gjobë.

të luftës dhe kime kundër njerëzimit, si dhe për vepra të tjera penale për të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk mund të zbatohet parashkrimi. Gjithashtu vepra penale e vrasjes së rëndë nuk parashkuhet."<sup>12</sup>

### **TË GJETURAT E PËRGJITHSHME:**

Nga gjithsej 17 gjykata komunale sa janë marrë në shqyrtim në ketë raport hulumtues, prej vitit 2001 deri në vitin 2012 janë parashkruar 8237 lëndë penale (duke përfshirë edhe parashkrimin e shqyrtimit të lëndëve edhe ekzekutimit të dënimive). Parashkrimi relativ i ka zënë 2911 lëndë penale ose 35.4% të totalit, ndërsa parashkrimi absolut i ka zënë 3917, ose 47.5% të lëndëve penale, kurse 1409 lëndë ose 17.1% e lëndëve janë të pa kategorizuara për nga aspekti i parashkrimit relativ ose absolut.

Po të shohim për nga përqindja e parashkrimit të lëndëve penale për nga aspekti relativ ose absolut, mund të themi se kemi një numër pak më të madh të lëndëve që parashkuhen në aspektin absolut. Mirëpo, kemi po ashtu një numër të madh të lëndëve

<sup>11</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 110 .

<sup>12</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës neni 111.

**Raport  
Monitorues** Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

që janë parashkruar në aspektin relativ, më tepër se 1/3 e lëndëve të parashkruara në total i përkasin parashkrimit relativ. Për aspektin relativ të parashkrimit të lëndëve penale duhet të fajësohen gjyqtarët që kanë lejuar parashkrimin e tyre ose kryetarin e gjykatës në të cilën janë parashkruar lëndët.

Faji i parashkrimit të lëndëve penale në aspektin relativ iu takon gjyqtarëve, për arsy se nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim juridik, i cili do të shtynte afatin e parashkrimit të lëndëve penale në dyfishin e paraparë më ligj. Ndërmarrja e çfarëdo veprimit juridik për lëndët e parashkrimit relativ, do t'i shtynte ato në parashkim absolut. Kjo nënkupton se një lëndë penale e dënueshme me tre vjet burgim parashkruhet në aspektin relativ pas kalimit të afatit ligjor prej pesë vjetësh. Në këtë rast, ka mjaftuar vetëm një veprim juridik i gjykatësit; p.sh. fillimi i shqyrimit të rastit ose lëshimi i urdhëresës për gjetjen e të dyshuarit, që afatin e parashkrimit të kësaj lënde ta dërgojë brenda afatit absolut, pra në dyfishin e afatit të paraparë ligjor, në dhjetë vjet.

Për fajin e parashkrimit të lëndëve penale, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës z. Fejzullah Hasani deklaron se nëse: "lënda është vjetërsuar për shkak të arritjes së afatit relativ mban përgjegjësi gjyqtari, nëse është vjetërsuar te prokurori mban përgjegjësi prokurori, nëse në polici mban policia"<sup>13</sup>.

<sup>13</sup> Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese; Preporr; "Amnistimi i Krimtit"; Besa Kalaja; <http://www.preporr.com/sq/Siguri-dhe-Gjyqesi/Amnistimi-i-krimtit-81>, e qasur më 12.02.2013.

**Raport  
Monitorues** Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

**Tabela 1. Parashkrimi i shqyrtimit të lëndëve dhe ekzekutimit të dënimive 2000/2012 në gjykatat komunale.**

Gjykatat Komunale	Parash. Relativ	Parash. Absolut	Të pa kategoriz uara/Ekze kutime Penale	Numri total i lëndëve të parashkrua ra
GJ. Komunale e Prizrenit	368	1183	-	<b>1551</b>
GJ. Komunale e Ferizajt	442	797	-	<b>1239</b>
GJ. Komunale e Rahovecit	385	515	149	<b>1049</b>
GJ. Komunale e Gjakovës	138	32	411	<b>581</b>
GJ. Komunale e Istogut	415	134	-	<b>549</b>
GJ. Komunale e Deçanit	508	6	27	<b>541</b>
GJ. Komunale e Klinës	-	-	523	<b>523</b>
GJ. Komunale e Prishtinës	91	322	105	<b>518</b>
GJ. Komunale e Pejës	374	61	13	<b>448</b>
GJ. Komunale e Malishevës	52	201	40	<b>293</b>
GJ. Komunale e Kaçanikut	3	256	-	<b>259</b>
GJ. Komunale e Kamenicës	75	58	84	<b>217</b>
GJ. Komunale e Suharekës	58	121	-	<b>179</b>
GJ. Komunale e Vushtrrisë		175		<b>175</b>
GJ. Komunale e Lipjanit	-	27	57	<b>84</b>
GJ. Komunale e Skenderaj	1	26	-	<b>27</b>
GJ. Komunale e Gllogocit	1	3	-	<b>4</b>
<b>TOTALI</b>	<b>2911</b>	<b>3917</b>	<b>1409</b>	<b>8237</b>

Sic shihet në tabelën 1, gjykatat që më së shumti kanë pasur parashkrim total të lëndëve penale në vitet 2001-2012 janë: gjykata komunale e **Prizrenit**, e **Ferizajt** dhe ajo e **Rahovecit**, ku veçmas këto gjykatë kanë shifër secila mbi 1000 lëndë të parashkruara.

Bashkërisht këto tri gjykata kanë një numër prej 3839 lëndësh, që nënkupton që përafërsisht gjysma e totalit të lëndëve të parashkruara ju përkasin këtyre tri gjykatave.

Gjykatat që më së shumti kanë lejuar parashkrimin relativ të lëndëve penale janë: gjykata komunale e **Deçanit**, e **Ferizajt**, e **Istogut**, e **Rahovecit**, e **Pejës** dhe e **Prizrenit**. Afërsisht 85% e lëndëve të parashkruara në aspektin relativ iu përkasin këtyre 6 gjykatave.




Figura 1 Parashkrimi i shqyrtimit të lëndëve dhe ekzekutimit të dënimive 2000/2012 në gjykatat komunale

### Trendët e Parashkrimit të Lëndëve Penale 2011-12

Në tryezën e organizuar nga Organizata ÇOHU! në janar 2012 "Parashkrimi i Lëndëve Penale 2001-2011", Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës z. Fejzullah Hasani, dhe koordinatori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor (në atë kohë) z. Kadri Begolli, patën deklaruar se tashmë kanë filluar te merren masat që në të ardhmen mos të ketë parashkrim të lëndëve penale, sidomos në aspektin relativ. Për dallim nga këto deklarime, parashkrimi i veprave penale, jo vetëm që ka vazhduar në vitet 2011-12, por është rritur tej mase numri i lëndëve që është parashkruar. Vetëm në vitet 2011-12, në 17 gjykatë komunale janë parashkruar 1845 lëndë penale.

Trendi i parashkrimit të lëndëve penale jo vetëm që nuk është ndalur, ose të paktën të fillojë të pakësohet, mirëpo në vazhdimësi po rritet, sidomos në vitet e fundit. Në disa gjykata komunale jo vetëm që kemi vazhdim të trendit të parashkrimin të lëndëve penale, por kemi një rritje marramendëse të numrit të parashkrimit. Gjykata Komunale e **Istogut**, në vitet 2001-10 ka pasur 242 lëndë të parashkruara, ndërsa në vitet 2011-12 ka 307 lëndë të parashkruara. Kjo tregon që në këtë gjykatë më shumë lëndë janë parashkruar në dy vitet e fundit se sa në dhjetë vitet paraprake. Po ashtu, edhe në gjykatat komunale të **Kaçanikut** dhe atë te **Suharekës** kemi më shumë lëndë që janë parashkruar në dy vitet e fundit se sa në dhjetë vitet paraprake. Numër të madh të parashkrimit të lëndëve penale në vitet 2011-12 kemi edhe në gjykatat komunale të **Ferizajt, Gjakovës, Prishtinës** dhe **Klinës**.

**Tabela 2. Krahasimi i parashkrimit të lëndëve dhe dënimive penale në gjykatat komunale në vitet 2000/2010 me vitet 2001/12**

Gjykatat Komunale	Parash. Relativ	Parash. Absolut	Të pa kategoriz uara	Numri i lëndëve të parashkruar a 2000/2010	Trendi i parashkri mit 2011/201 2	TOTALI
GJ. Komunale e Ferizajt	400	470	-	870	369	1239
GJ. Komunale e Prizrenit	357	1179	-	1536	15	1551
GJ. Komunale e Rahovecit	385	515	149	1049	-	1049
GJ. Komunale e Deçanit	508	6	-	514	27	541
GJ. Komunale e Gjakovës	137	20	304	461	120	581
GJ. Komunale e Pejës	374	61	-	435	13	448
GJ. Komunale e Klinës	-	-	299	299	224	523
GJ. Komunale e Prishtinës	47	229	-	276	242	518
GJ. Komunale e Istogut	212	30	-	242	307	549
GJ. Komunale e Malishevës	45	169	-	214	79	293
GJ. Komunale e Kaçanikut	2	91	-	93	166	259
GJ. Komunale e Kamenicës	55	36	49	140	77	217

<b>GJ. Komunale e Suharekës</b>	34	44	-	<b>78</b>	<b>101</b>	<b>179</b>
<b>GJ. Komunale e Vushtrrisë</b>		151		<b>151</b>	<b>24</b>	<b>175</b>
<b>GJ. Komunale e Lipjanit</b>	-	17	-	<b>17</b>	<b>67</b>	<b>84</b>
<b>GJ. Komunale e Skenderaj</b>	1	12	-	<b>13</b>	<b>14</b>	<b>27</b>
<b>GJ. Komunale e Glogocit</b>	1	3	-	<b>4</b>	-	<b>4</b>
<b>TOTALI</b>	<b>2558</b>	<b>3033</b>	<b>801</b>	<b>6392</b>	<b>1845</b>	<b>8237</b>

Tabela 2, tregon se trendi i parashkrimit të lëndëve penale, jo vetëm që nuk është ndalur, por shihet tendencë e rritjes së numrit. Nga të dhënrat e marra nga gjykatat komunale, shihet qartë se një numër i madh i lëndëve penale do të parashkruhen edhe në vitet e ardhshme.





Figura 2: Krahasimi i parashkrimit të lëndëve dhe dënimive penale në gjykatat komunale në vitet 2000/2010 me vitet 2011/12

**Tabela 3. Parashkrimi i lëndëve dhe dënimive penale i klasifikuar në vite.**

Vitet	Parash. Relativ	Parash. Absolut	Të pa kategorizuara	Totali i lëndëve
<b>2001</b>	17	10	5	<b>32</b>
<b>2002</b>	27	23	4	<b>54</b>
<b>2003</b>	88	117	13	<b>218</b>
<b>2004</b>	96	502	39	<b>637</b>
<b>2005</b>	458	419	57	<b>934</b>
<b>2006</b>	181	327	41	<b>549</b>
<b>2007</b>	331	172	49	<b>552</b>
<b>2008</b>	222	103	91	<b>416</b>
<b>2009</b>	39	86	-	<b>125</b>
<b>2010</b>	64	163	-	<b>227</b>
<b>2011</b>	112	628	149	<b>889</b>
<b>2012</b>	311	481	297	<b>1089</b>
<b>Të pa kategorizuara ne vite</b>			2515	<b>2515</b>
<b>TOTALI</b>	<b>1946</b>	<b>3031</b>	<b>3260</b>	<b>8237</b>

Po të shikojmë tabelën 3, të parashkrimit të lëndëve penale të kategorizuara në vite, del se vitet që më së shumti janë parashkruara lëndë penale janë: viti 2012, me 1089 lëndë të parashkruara, viti 2005 me 934 lëndë të parashkruara, dhe viti 2011 me 889 lëndë të parashkruara. Në aspektin relativ më së shumti lëndë janë parashkruar në vitin 2005, me 458 lëndë të parashkruara. Ndërsa në aspektin absolut, më së shumti lëndë janë parashkruara në vitet 2011-12, me 628 lëndë të parashkruara në vitin 2011, dhe 481 lëndë në vitin 2012.

**Figura 3: Trendi i parashkrimit të lëndëve penale në vite, të ndara në a) relativ; b) absolut; dhe c) të kategorizuara.**

Nëse krahasohet parashkrimi i lëndëve penale të kategorizuara në vite, del se, vitet 2011-12 kanë më së shumti lëndë të parashkruara. Kjo është periudha kohore ku pikërisht edhe ka filluar reformimi i sistemit gjyqësor, duke ngërthyer në vete riemërimin e prokurorëve, gjyqtarëve dhe rritjen e numrit të gjyqtarëve në disa gjykata komunale që kanë pasur nevojë. Nga gjysma e dytë e vitit 2012, ka filluar rritja e numrit të gjyqtarëve në disa gjykata komunale që kanë pasur mungesë gjyqtarësh. Kryetari i Gjykatës Komunale të Klinës z. Jashar Gashi, deklaron se kjo gjykatë prej vitit 2010 e deri në gusht 2012 ka pasur vetëm një gjyqtar, gjë me të cilën edhe e arsyeton numrin e madh të parashkrimit të lëndëve në ketë gjykatë. Mirëpo, me emërimin edhe të tre gjyqtarëve tjerë në këtë gjykatë është përmirësuar gjendja, dhe se ka filluar shqyrtimi i lëndëve të vjetra për t'iu ikur afateve të parashkrimit të tyre.

**Veprat penale që janë parashkuar më së shumti ju përkasin kapitujve:**

- Kapitulli 15 -Veprat Penale Kundër Jetës dhe Trupit,
- Kapitulli 23-Veprat Penale Kundër Pasurisë,
- Kapitulli 24-Veprat Penale Kundër Mjedisit, Kafshëve, Bimëve dhe Objekteve Kulturore, dhe
- Kapitulli 28- Veprat Penale Kundër Rendit Publik dhe Veprimeve Juridike.

**Raport  
Monitorues** Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

Marrë së bashku, vetëm nga këto katër kapituj të KPRK-së janë parashkruar 3341 lëndë penale, që përfshinë gati gjysmën e totalit të lëndëve të parashkruara nga gjithsej 17 kapituj sa ka pjesa e posaçme e KPRK-së. Po të shikojmë tabelën e më poshtme, del se 1239 lëndë janë parashkruar që i përkasin kapitullit 23 të KPRK-së- veprat penale kundër pasurisë. Janë pikërisht veprat penale që i përkasin këtij kapitulli të KPRK-së, me anë të të cilave gjykatat duhet të mbrojnë qytetarët e tyre, sepse me këto vepra penale edhe cenohet pasuria private e qytetarëve dhe njëherazi edhe mirëqenia e tyre.

Nëse kthehen në përqindje, del se 78% e lëndëve të parashkruara (3341 lëndë), që janë të kategorizuara në kapituj të KPRK-së, janë lëndë që ju përkasin këtyre katër kapitujve. Ndërsa rreth 22% e lëndëve tjera të parashkruara (918 lëndë), ju përkasin 13 kapitujve të tjerë të KPRK-së dhe ligjeve tjera penale. Veprat penale kundër pasurisë, me anë të të cilave edhe mbrohet pasuria e qytetarëve, janë parashkruar në numrin më të madh edhe në aspektin relativ me gjithsej 615 lëndë. Kjo me fajin e gjuqtarëve që nuk marrin veprime juridike për ndërprerjen e afatit relativ të parashkrimit, kështu duke mundësuar vjetërsimin e lëndëve me të cilat në një mënyrë mbrohet edhe mirëqenia e qytetarëve.

**Raport  
Monitorues**

Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

Tabela 4. Parashkrimi i Lëndëve Penale të ndara në bazë të kapitujve të Kodit Penal të Kosovës (KPRK-së)

Kapitujt sipas KPRK-së	Parash. Relativ	Parash. Absolut	Të pa kategorizuar	Totali i lëndëve
Kap.13 <u>Veprat Penale Kundër Kosovës dhe Banorëve të saj,</u> Nenet 108-115	08	10	01	19
Kap.14 <u>Veprat Penale Kundër të Drejtës Ndërkombëtare</u> Nenet 116-145	01	12	-	13
Kap.15 <u>Veprat Penale Kundër Jetës dhe Trupit</u> Nenet 146-157	140	227	04	371
Kap.16 <u>Veprat Penale Kundër Lirive dhe të Drejtave të Njeriut</u> Nenet 158-181	67	117	01	185
Kap.17 <u>Veprat Penale Kundër të Drejtave në Marrëdhënie të Punës</u> Nenet 182-186	04	33	-	37
Kap.18 <u>Veprat Penale Kundër Nderit dhe Autoritetit</u> Nenet 187- 191	08	16	-	24
Kap.19 <u>Veprat Penale Kundër Integritetit Seksual</u> Nenet 192- 204	14	09	03	26
Kap.20 <u>Veprat Penale Kundër Martesës dhe Familjes</u> Nenet 205- 214	02	08	-	10
Kap.21 <u>Veprat Penale Kundër Shëndetit Publik</u> Nenet 215- 231	03	06	-	09
Kap.22 <u>Veprat Penale Kundër Ekonomisë</u> Nenet 232- 251	34	42	-	76
Kap.23 <u>Veprat Penale Kundër Pasurisë</u> Nenet 252-275	615	608	16	1239
Kap.24 <u>Veprat Penale Kundër Mjedisit, Kafshëve, Bimëve dhe Objekteve Kulturore.</u> Nenet 276-290	515	427	10	952
Kap.25 <u>Veprat Penale Kundër Sigurisë së Përgjithshme të Njerëzve dhe Pasurisë.</u> Nenet 291-296	38	62	01	101
Kap.26 <u>Veprat Penale Kundër Sigurisë së Trafikut</u> Nenet 297-302	38	65	02	105
Kap.27 <u>Veprat Penale Kundër Administrimit të Drejtësisë</u> Nenet 303- 215	18	11	02	31
Kap.28 <u>Veprat Penale Kundër Rendit Publik dhe Veprimeve Juridike.</u> Nenet 316-338	339	431	09	779
Kap.29 <u>Veprat Penale Kundër Detyrës Zyrtare</u> Nenet 339-351	10	21	-	31
Sipas Ligjeve tjera Penale(LPK)	23	48	180	251
<u>Të pa Kategorizuar në nene sipas KPRK-së</u>	785	1075	2118	3978
<b>TOTALI</b>	<b>2662</b>	<b>3228</b>	<b>2347</b>	<b>8237</b>




Figura 4: Numri i lëndëve të parashkruara sipas kapitujve të KPRK-së.

Veprat penale që janë parashkruar më së shumti, në fakt iu përkasin kapitujve të KPRK-së që po ashtu kanë më së shumti vepra penale të parashkruara. 2597 lëndë që janë parashkruar i përkasin vetëm pesë veprave penale që janë: Neni 332- **Falsifikimi i Dokumentit** me 400 lëndë, Neni 285- **Vjedhja e Pyllit** me 938 lëndë, Neni 261- **Mashtrimi** me 302 lëndë, Neni 252- **Vjedhja** me 587 lëndë, , dhe Neni 153- **Lëndim i Lehtë Trupor** me 370 lëndë

Tabela 5. Veprat Penale që janë parashkruar më së shumti.

Kapitujt sipas KPRK-së	Neni dhe Vepra Penale	Numri i Lëndëve
<b>Kap 28 i KPRK-së</b>	Neni 332- Falsifikimi i Dokumentit	<b>400</b>
<b>Kap 24 i KPRK-së</b>	Neni 285- Vjedhja e Pyllit	<b>938</b>
<b>Kap 23 i KPRK-së</b>	Neni 261- Mashtrimi	<b>302</b>
<b>Kap 23 i KPRK-së</b>	Neni 252- Vjedhja	<b>587</b>
<b>Kap 15 i KPRK-së</b>	Neni 153- Lëndim i Lehtë Trupor	<b>370</b>
<b>TOTALI</b>		<b>2597</b>

Rreth 60% e lëndëve të parashkruara që janë të kategorizuara në bazë të kapitujve të KPRK-së, iu përkasin pikërisht këtyre pesë veprave penale. Është shqetësuese se si në gjykatat komunale janë parashkruar 938 lëndë që i përkasin veprës penale, vjedhje e pyllit (neni 285 KPRK), ose me tepër se 11% e lëndëve të parashkruara i përkasin pikërisht kësaj vepre penale. Gjykatat komunale nuk janë të interesuara, siç duket nga të dhënat e këtij raporti, të dënojnë njerëzit të cilët e kryejnë këtë vepër penale (vjedhja e pyllit), me të cilën jo vetëm që i shkaktojnë dëm vendit, mirëpo njëkohësisht dëmtojnë dhe degradojnë edhe ambientin.




Figura 5: Përgindja e ndarjes së parashkrimit të lëndëve penale sipas neneve të KPRK-së.

**Parashkrimi i lëndëve kundër detyrës zyrtare/korrupsionit:**

Përkundër deklaratave të gjykatësve, por edhe të zyrtarëve të lartë politik, se lëndët që janë kundër detyrës zyrtare/korrupsionit kanë prioritet dhe që nënkupton se nuk mund të ketë parashkrim të lëndëve penale kundër detyrës zyrtare<sup>14</sup>, kemi parashkrim edhe të lëndëve të po kësaj natyre.

Janë gjithsej 31 lëndë kundër detyrës zyrtare/korrupsionit që janë parashkruar, prej të cilave, 10 janë të parashkruar në aspektin relativ, për të cilat duhet të fajësohen gjykatat, dhe 21 janë të parashkruar në aspektin absolut. Kjo do të thotë se gjykatat komunale të Kosovës nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim juridik për ndalimin e afatit të parashkrimit relativ të lëndëve kundër detyrës zyrtare/korrupsionit, të cilat e dëmtojnë direkt edhe buxhetin e vendit dhe prekin drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve.

**Tabela 6. Veprat Penale kundër detyrës zyrtare që janë parashkruar.**

Neni dhe Vepra Penale	Gj. K. Prishtinës	Gj. K. Istogut	Gj. K. Ferizaj	Gj. K. Gjakovës	Gj. K. Lipjanit	Gj. K. Malishevës	Gj. K. Suharekës	Gj. K. Kamenicës	TOTALI
<b>Neni 339 Shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit</b>	5	3	3	5	1	1	-	5	<b>23</b>
<b>Neni 343 Marrja e ryshfetit</b>	-	-	5	-	-	-	-	-	<b>5</b>
<b>Neni 348 Falsifikim i dokumenteve zyrtare</b>	2	-	-	-	-	-	1	-	<b>3</b>
<b>TOTALI</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>8</b>	<b>5</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>31</b>

Veprat penale kundër detyrës zyrtare që janë parashkruar janë: **neni 339 shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit 23 lëndë, nen 343 marrje e ryshfetit 5 lëndë, dhe nen 348 falsifikimi i dokumentit zyrtar** ka 3 lëndë janë parashkruar.

<sup>14</sup> Në një intervistë dhënë Organizatës ÇOHU!, Kryetari i Gjykatës Supreme z. Fejzullah Hasani, ka dekluaruar se nuk mund të ketë parashkrim të lëndëve kundër detyrës zyrtare/korrupsionit, për arsy se afati i parashkrimit është më i gjatë. Ai ka dekluaruar se lëndët të cilat mund të parashkruhen janë kryesisht vepra penale të lehta të cilat afatin e parashkrimit e kanë të shkurtër. Intervista është zhvilluar në Gjykatën Supreme me 17-06-2010.




Figura 6: Lëndët kundër detyrës zyrtare (korruptionit) që janë parashkruar gjatë viteve 2001-2012.

Sipas raportit monitorues të Organizatës ÇOHU! "Shqyrtimi i Veprave të Korruptionit nga Organet e Drejtësisë<sup>15</sup>" del se në vitet 2008-2011, në gjykatat komunale dhe të qarkut gjatë viteve 2008-2011, janë shqyrtaar vetëm **29.7 %** e lëndëve që kanë qenë në punë. Nga **29.7 %** e lëndëve të gjykuara nga gjykatat komunale dhe të qarkut për vitet 2008-11, vetëm **18.3 %** e tyre kanë përfunduar me aktgjykime dënuese, ku prej tyre **8.6 %** kanë përfunduara me gjobë. Ndërsa **11.3 %** e lëndëve të gjykuara kanë përfunduar me aktgjykim lirues. Nga kjo shihet që gjykatat komunale, jo vetëm që nuk po i shqyrtojnë lëndët penale me natyrë korruptive, por këto gjykata madje po lejojnë edhe parashkrimin e tyre. Nga tabela 6, shihet se në tetë gjykata komunale kemi pasur parashkrim edhe të lëndëve penale kundër detyrës zyrtare/korruptionit.

Gjykatat që më së shumti kanë lejuar parashkrimin/vjetësimin e lëndëve penale kundër detyrës zyrtare janë: gjykata komunale e Ferizajt me 8 lëndë të parashkruara dhe ajo e Prishtinës me 7 lëndë të parashkruara. Gjykata komunale e Ferizajt është e vetmja që ka lejuar edhe parashkrimin e veprës penale marrje e ryshfetit (neni 343). Në këtë gjykatë kemi pesë lëndë penale, marrje e ryshfetit, që janë parashkruar.

<sup>15</sup> Organizata ÇOHU!; "Shqyrtimi i Veprave të Korruptionit nga Organet e Drejtësisë"; Janar 2012.

<http://www.cohu.org/sq/Hulumtime-i/Shqyrtimi-i-Veprave-t-Korruptionit-nga-Organet-e-Drejt-sis-130>

**Raport  
Monitorues** Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i  
Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të  
Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

Numri i lartë i parashkrimit të lëndëve, përgjatë këtyre viteve të marrë në shqyrtim, ndodhë si pasojë e tendencës për të plotësuar normën e përcaktuar të lëndëve që duhet shqyrtuar dhe mbyllur përgjatë një viti nga një gjyqtar. Për të plotësuar këtë normë, gjyqtarët kanë neglizhuar afatet ligjore, duke vrapuar në përbushjen e numrave/normave, pa e konsideruar edhe rrezikun e vjetërsimit të lëndës. “Nëse do të kishin qenë më të kujdeshëm, parashkrimi nuk do të kishte ndodhur përfajin e gjyqtarëve, sepse fundi i fundit fajtor për parashkrimin absolut nuk jemi ne”<sup>16</sup>.

Përkundër faktit që 54 % e lëndëve që janë parashkuar në vitet 2001-2010, i përkasin parashkrimit relativ, pa illogaritur edhe ato të pa kategorizuara, prapë se prapë nuk është ndërmarrë asnjë veprim kundër përgjegjësve të këtyre parashkimeve.

Nga 8237 lëndë të parashkuar gjithsej nga gjykatat komunale të Kosovës që janë marrë për shqyrtim, 3917 lëndë i përkasin parashkrimit absolut, që nënkupton se ka kaluar dyfishi i afatit të paraparë me KPRK, për parashkrim/vjetërsim. Për lëndët që janë parashkuar në aspektin absolut, nuk ekziston asnjë mundësi që të ndërmerrë ndonjë veprim nga gjykatat, për arsy se tek parashkrimi absolut i lëndëve, barra e përgjegjësisë nuk qëndron tek gjykatat, sepse ka kaluar dyfishi i kohës së paraparë më ligj për ndjekjen penale ose ekzekutimin e dënimive. Kjo për arsy se ose nuk ka qenë e mundur të gjendet pala e dyshuar, ose nuk është arritur të gjendet i dënuari.

Kryetarët e shumicës së gjykatave komunale janë arsyetuar se numri kaq i madh i parashkrimit të lëndëve ka ndodhur për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve dhe stafit të kufizuar administrativ të gjykatave. Kjo sa i përket parashkrimit të ndjekjes penale. Faktori objektiv, mungesa e gjyqtarëve, për një kohë shumë të gjatë ka ndikuar në rritjen e lëndëve, të cilat pastaj po vijnë deri te vjetërsimi.

Sipas Zyrës së Prokurorit Disiplinor, janë "kryer disa hetime disiplinore për një numër të konsiderueshëm të rasteve që kanë të bëjnë me parashkrimin e lëndëve penale dhe ekzekutimeve penale"<sup>17</sup>. Janë gjithsej 10 raste<sup>18</sup> që janë hetuar nga ZPD-ja, e që kanë të bëjnë më lejimin e parashkrimit të lëndëve penale. Lëndët që janë shqyrtuar nga ZPD-ja, janë: 2 lëndë të vitit 2012, 5 lëndë të vitit 2011, 2 lëndë të viti 2009 dhe 1 lëndë e vitit 2008. Nga 10 lëndët e hetuara ne ZPD-ja, gjashtë prej tyre janë dërguar në komisionet përkatëse disiplinore, ndërsa katër prej tyre janë hedhur poshtë si të pa baza.

Lejimi më qëllim i parashkrimit relativ të lëndëve mund të jetë vepër penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe për këtë, gjyqtarët duhet të ndiqen penalisht.

<sup>16</sup> Intervistë me Fejzullah Hasani-Krytar i Gjykatës Supreme të Kosovës, 19-01-2012.

<sup>17</sup> Intervistë me kordinatorin e ZPD. Zef Prendrecaj. me 10-12-2012 Prishtinë.

<sup>18</sup> Nga dhjetë rastet sa i ka hetuar ZPD-ja: 2 janë nga gjykata komunale e Prishtinës, 1 nga ajo e Suharekës, 1 nga ajo e Gjilanit, 1 në Zubin Potok, 1 në Prezren, 1 në Gjakovë, 1 në Klinë, 1 në Dragash dhe 1 në prokurorinë e qarkut të Prishtinës.

Kryeprokurori i Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë z. A. Lumezi, deklaron se: "unë e di që në gjykata ka pasur numër të madh të lëndëve të pakryera dhe për shkak të ngarkesës së madhe ka ardhur deri të parashkrimet. Ne deri me tani nuk kemi informata se është keqpërdorur detyra zyrtare. Po të kishim informata se kjo është bërë me qëllim që lëndët të arrijnë deri të parashkrimi sigurisht që do t'i kishim hetuar ata gjyqtarë"<sup>19</sup>.

Përgjegjësit e parashkrimit të mijëra lëndëve mund të mbesin edhe pa u ndëshkuar për faktin se pjesa më e madhe e gjyqtarëve të cilët kanë kryer veprime të tilla tashmë nuk janë duke punuar si gjyqtarë, përkatësisht ose janë punësuar si avokatë ose janë nuk janë riemëruar në procesin e riemërimit<sup>20</sup>.

Ndërsa sa i përket parashkrimit të ekzekutimit të dënimive, gjyqtarët arsyetohen se nuk ka një gatishmëri të Policisë së Kosovës për përgjigje në urdhëresat e gjykatave për arrestimin e të dënuarve. Po ashtu, gjyqtarët arsyetohen se në shumë raste kanë probleme me adresat e të dyshuarve dhe të dënuarve, pasi që nuk arrihet të gjinden në adresat që kanë ata. "Adresat për gjykatat kanë paraqitë problem sepse kjo ka ndikuar te gjykatat për zvarritjen e rasteve, shtyrje të afatit dhe ka krijuar shpenzime të mëdha, sepse është dashur tre-katër herë të kërkohet pala. Kur është në pyetje policia kjo nuk qëndron, sepse ata janë të thirrur të gjejnë edhe adresat, ata e kanë operativën e vetë për t'i gjetur adresat."<sup>21</sup>

Gjithashtu, problem në fillimin e ndjekjes dhe fillimin e ekzekutimit të dënimive është edhe arratia e të dyshuarve dhe të dënuarve. Një numër i madh i të dyshuarve dhe të dënuarve gjenden në botën e jashtme dhe nuk mund të arrestohen dhe të sillen në gjykim ose në vuajtje të dënimive të shqiptuara. Shembull i fundit është kur ish-kryetari i Komunës së Kaçanikut dënohet me tre vjet burgim, ndërsa i dënuari arratiset nga vendi për të mos vuajtur dënimin e shqiptuar. Në këtë rast, kemi një negligencë të gjykatës, ose trupit gjykues, për arsy se të dënuarit nuk i janë marrë dokumentet e udhëtimit në mënyrë që të pengohet arratisja e tij. Ky rast mund të parashkruhet në një afat prej pesë viteve në aspektin relativ, dhe pas kësaj kohe i dënuari kthehet nga arratia dhe organet kompetente nuk mund ta dërgojnë të dënuarin në vuajtje të dënitit. Po ashtu edhe me rastin e gjykit të akuzuarve në rastin "Bllaca 2", ditën kur është shpallur aktgjykimi, janë arratisur të akuzuarit (pas shpalljes së vendimit të dënuarit) Driton Hajdari, Bekim Syla dhe Shpresim Uka.

Të tre të akuzuarit, tashmë të dënuar: Shpresim Uka, Driton Hajdari e Bekim Syla kanë qenë vazhdimisht prezent gjatë seancave gjyqësore ku ata akuzoheshin për krime

<sup>19</sup> Kosova Sot "[Disa gjyqtarë nën Hetime](#)", 9-dhjetor 2011, faqe 5.

<sup>20</sup> Kosova Sot, "[Në qershorr nisin hetimet për vietërsimin e lëndëve](#)", 13 maj 2011, faqe 9.

<sup>21</sup> Intervistë me Fejzullah Hasani-Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, 19-01-2012.

**Raport  
Monitorues** Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i  
Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të  
Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

serioze, përveç në ditën kur u shpall vendimi final i trupit gjykues.<sup>22</sup> Edhe në ketë rast, sikurse në rastin e ish-kryetarit të Kaçanikut, arratisja e të akuzuarve (tash të dënuarve), mund të thuhet se faji është i gjyqtarëve, të cilat nuk i kanë marrë masat e nevojshme për të siguruar prezencën e të akuzuarve në seancën përfundimtare dhe njëkohësisht edhe vuajtjen e dënimive. Të gjitha këto raste mund të parashkruhen pas kalimit të afatit ligjor të vjetërsimit.

Shumë gjykata komunale arsyetohen se kanë një numër të madh të parashkrimit të ekzekutimeve të dënimive, d.m.th. gjykata i ka shqyrtau lëndët, ka shqiptuar dënimet, por nuk është arritur të arrestohen nga Policia e Kosovës për t'u sjellë në institucionet korrektuese për të vuajtur dënimet e shqiptuara. Mos arrestimi i tyre me kohë, ka sjellë edhe parashkrimin e ekzekutimeve të dënimive. Për këtë, gjykatat fajësojnë policinë, "ndodhë që tri herë të dërgohen urdhëresa tek policia dhe ata nuk përgjigjen në urdhëresa"<sup>23</sup>. Përkundër kësaj, kryetari i Gjykatës Supreme Fejzullah Hasani, thotë se bashkëpunimi me policinë ka qenë korrekt, por mund të themi se ka pasur segmente ku kemi pasur probleme. Ka qenë njësiti që merret me urdhëresat e gjykatave, këtu kemi probleme dhe kjo dëshmohet te parashkrimi absolut, sepse parashkrimi absolut nuk ndodhë për shkak të gjykatave.

Po ashtu, problemi qëndron se policia me rastin e pranimit të kallëzimit penal nuk i merr të gjitha të dhënat e nevojshëm që obligohen me ligj të merren, pastaj lindë problemi i adresave<sup>24</sup> të të dyshuarve.

Një numër i madh i lëndëve penale parashkruhen edhe në prokurori, në procedurën hetimore. Në përgjithësi nga 1049 lëndë që janë parashkuar në gjykatën komunale të Rahovecit, 166 lëndë janë parashkuar në prokurori para se të arrijnë në ketë gjykatë. Është mjaft shqetësues fakti që lëndët po parashkruhen në të gjitha instancat gjyqësore, si në prokurori, gjykata dhe në polici. Pikërisht, institucionet që me anë të akteve më të larta shtetërore, janë të thirrura për të luftuar dhe parandaluar krimin, ato po lejojnë që kryesit e krimtit të mbisin në liri, përmes parashkrimit/vjetërsimit të lëndëve penale.

<sup>22</sup> Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese; Preporr; "Gjyqtari që mundësoi arratisjen; <http://www.preporr.com/sq/Siguri-dhe-Gjyqesi/Gjyqtari-q-mundsoi-arratisjen-262>; qasur më 02.13.2013.

<sup>23</sup> Znj. Safete Tolaj, Kryetare e Gjykatës Komunale e Deçanit në intervistën dhënë Organizatës ÇOHU!

<sup>24</sup> Vërtetë është një problem shumë kompleks ky i parashkrimit të lëndëve penale. Gjyqësori po përballet me probleme le të themi më banale, për shembull emërtimin e rrugëve. Kadri Begolli 18-01-2012.

**Raport  
Monitorues** Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

**Marrë në përgjithësi arsyetimet e gjyqtarëve rreth vjetërsimit të lëndëve panele janë:**

- Numri i madh i lëndëve,
- Numri i vogël i gjyqtarëve,
- Mos gjetja e të pandehurve as nga ana e gjykatës, as nga policia,
- Adresat e gabuara,
- Fshehja e të pandehurve për t'i shbangur përgjegjësisë penale,
- Mos-prania e të akuzuarit,
- Mos-zbatimi i urdhëresave të gjykatave nga policia,
- Lëndët jo të kompletuara nga prokuroritë,
- Parashkrimi në procedurën hetimore në prokurori (rasti i Rahovecit),
- Mungesa e stafit ndihmës gjyqësor,
- Parashkrimi në procedurën parapenale në polici,<sup>25</sup>
- Mos-zëvendësimi i gjyqtarëve etj.

{Arsyetimet e gjykatave rreth parashkrimit të lëndëve mund të janë reale sa i përket lëndëve që janë parashkruar nga aspekti absolut, mirëpo nuk janë reale sa iu përket parashkimeve relative, sepse gjykatat nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim ligjor për të ndërprerë afatin e parashkrimit}

Arsyetimet e gjykatave rreth parashkrimit të lëndëve mund të janë reale sa i përket lëndëve që janë parashkruar nga aspekti absolut, mirëpo nuk janë reale sa iu përket parashkimeve relative. Kjo duke qenë se gjykatat nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim ligjor për të ndërpren afatin e parashkrimit. Kjo nënkupton se gjykatat nuk i kanë marrë fare në shqyrtim gjyqësor lëndët që janë parashkruar në aspektin relativ, dhe kështu kanë lejuar parashkrimin e tyre pa i shqyrtuar fare. "Parashkrimi relativ lë për të dyshuar se mos këtu diçka ka ndodhur, nuk ka sinjale të mira, nëse del se parashkrimi relativ ka ndodhur për shkak të keqpërdorimeve apo abuzimeve atëherë do të ndërmerren masa"<sup>26</sup>. Dhe për këtë duhet të fajësohen gjyqtarët që kanë qenë të ngarkuar me ato lëndë. "Nuk qëndron fakti se gjyqtarët kanë qenë të ngarkuar me lëndë, ngase sa do të jetë i ngarkuar me lëndë gjyqtari, nuk duhet të lejojë që nga mospuna e tij të vjetërohet

<sup>25</sup> Gjykata Komunale e Pejës arsyetohet se shumica e lëndëve të parashkruara kanë ardhur të parashkruar në procedurën parapenale në polici.

<sup>26</sup> Intervistë me Fejzullah Hasani-Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, 19-01-2012.

## Raport Monitorues

### Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

lënda. Dhe kjo është lehtë të vërtetohet, që nëse një gjyqtar është marrë vetëm me lëndë që nuk kanë qenë afër vjetërsimit, pra është marrë me numra e nuk është marrë me lëndë që kanë qenë në rrezik të rënies në parashkrim, d.m.th. tregon se ai e ka neglizhuar çështjen.”<sup>27</sup>

#### Përfundimi

Parashkrimi i lëndëve penale paraqet njërin ndër problemet dhe sfidën më thelbësore të konsolidimit të sistemit të drejtësisë. Ky raport monitorues, ka shfaqur një tendencë shqetësuese mbi trendin e parashkrimit të lëndëve penale. Raporti tregon që gjatë vitit 2012, numri i lëndëve penale të parashkruara ka qenë më i larti që nga viti 2001. Ky raport, në kundërshtim me deklarimet e zyrtarëve të lartë të gjyqësorit, për ndalim të trendit të parashkrimit të lëndëve penale, ka treguar ritëm krejt të kundërt të numrit të lëndëve të parashkruara. Për më keq, rritja e numrit të parashkrimit të lëndëve penale gjatë dy viteve të fundit, eksponzon se tendanca e parashkrimit të lëndëve penale do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Në këtë raport monitorues, është treguar që në vetëm 17 gjykata komunale, numri i lëndëve penale të parashkruara shkon mbi 8000 sosh. Vetëm gjatë viteve 2011 dhe 2012, kemi 889, respektivisht 1089 lëndë penale të parashkruara. Një rritje e tillë e numrit të lëndëve penale të parashkruara ka ndodhur në kohën kur Strategjia për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra do të duhej të jepte efektin e saj.

Këtu pasqyrohet edhe fakti që në kuadër të lëndëve të parashkruara, ka edhe lëndë që hyjnë në kuadër të kapitullit të XXXIV të KPRK-së, të klasifikuara si: “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”. Në kuadër të këtij kapitulli, raporti tregon që në vetëm 17 gjykata komunale, kemi 31 raste të korruptionit që janë parashkruar.

Raporti ka treguar që ka një ndarje jo proporcionale në mes të parashkrimit absolut, me 47.5% dhe atij relativ, me 35.4%. Përderisa 17.1% e lëndëve janë ose të pakategorizuara ose janë ekzekutime. Ashtu siç tregon raporti, përgjegjësia për parashkrimin relativ bie kryekëput mbi gjyqtarët, të cilët duket mos marrë asnjë veprim juridik, kanë lejuar parashkrimin e lëndëve. Vetëm një veprim juridik i gjyqtarëve, do të mundëson zjatjen e afatit të parashkrimit, dhe kështu zjatjen e afatit të parashkrimit të lëndëve.

<sup>27</sup> Intervistë me Fejzullah Hasani-Krytar i Gjykatës Supreme të Kosovës, 19-01-2012.

**Raport  
Monitorues** Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i  
Ekzekutimit të Dënimive në Gjykatat Komunale të  
Republikës së Kosovës në vitet 2001-2012

Rritja e numrit të parashkrimit të lëndëve penale ka ardhur edhe si pasojë e mos kërkimit të përgjegjësisë nga ana e organeve mbikëqyrëse. Deri më tani, Zyra e Prokurorit Disiplinor, për mbi 8000 lëndë të parashkruara në 17 gjykata komunale, ka iniciuar hetim për vetëm 10 raste, prej të cilave, 6 i ka dërguar në komisionet përkatëse disiplinore, ndërsa 4 i ka hedhur poshtë.

Me gjithë se sistemi gjyqësor nga viti 2013 ka një strukturë të re organizative, ritmi i parashkrimit të lëndëve penale do të vazhdojë. Gjyqësori në Kosovë, ballafaqohet me probleme substanciale dhe si i tillë, vështirë se do të mund të ndalojë trendin e parashkrimit të lëndëve penale edhe në vitet në vijim. Por, institucionet mbikëqyrëse nuk mund më të rrinë duarkryq përballë kësaj dukurie duke lejuar ikjen nga përgjegjësia e gjykatësve që lejojnë parashkrimin e lëndëve. Trendi në rritje i parashkrimit të lëndëve penale do të duhej të fillojë të bie tash me organizimin e ri të sistemit të drejtësisë.